

## **KONTRATË TRANSFERIMI AKSIONESH**

Sot më datë datë 10/07/2019, në Tiranë, palët e mëposhtme vendosën të lidhin kete kontratë per transferimin e aksioneve, me kushtet dhe afatet vijuese:

**SHITËSE:** Znj. Jorgjia BALLI, shtetase shqiptare, lindur më datë 05.08.1947 në Berat, banuese në Tiranë, identifikuar me Pasaporten Nr.0426071, madhore, me zotësi të plotë e për të vepruar *[në cilësinë e Shiteses]*,

Dhe

**BLERËSI:** Z. Renis TËRSHANA, i biri i Agimit, i datelindjes 23.09.1971, lindur në Tiranë. dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga e Elbasanit Nr. 17, identifikuar me letërnjoftimin Nr. 027887821, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar *[në cilësinë e Bleresit]*.

**OBJEKTI:** Transferimi i 5,816 (*pese mijë e tetëqind e gjashtëmbdhjetë*) aksioneve të “BANKA CREDINS” sh.a, që zotërohen nga aksionarja **Znj. Jorgjia BALLI** dhe perfitimi i tyre nga aksionari **Z. Renis TËRSHANA**.

### **PËRMBAJTJA E KONTRATËS**

Shoqëria «BANKA CREDINS» SH.A., është një shoqëri anonyme e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Nr. 28969, datë 31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT K31608801O si dhe me licencën Nr.16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Referuar nenit 9.4/ii, të Statutit të shoqërisë “BANKA CREDINS” SH.A., dhe nenit 6.13 të Marrëveshjes së Investimit, shitësja Znj. Jorgjia BALLI përmes kësaj kontrate ushtron të drejtën e të transferimit të pronesise mbi aksionet objekt kontrate.

**Shitësja**, Znj. Jorgjia BALLI zotëron 433,832 aksione (*katerqind e tridhjete e tre mijë e tetëqind e tridhjete e dy*), që perfaqesojne një pjesemarje 0.511% ne kapitalin e shoqërisë “BANKA CREDINS” SH.A., sic rezulton dhe vërtetohet nga dokumentet e shoqërisë. Nga totali i aksioneve që zotërohen nga ana e saj, si me siper, nepermjet kesaj kontrate transferohen ne pronesi të aksionerit z.Renis Tershana 5,816 (*pese mijë e tetëqind e gjashtëmbdhjetë*) aksione, te cilat zotërohen nga znj.Jorgjie Balli



## ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE DHE MËNYRA E PAGESËS.

Paketa prej 5,816 (*pese mijë e teteqind e gjashtembedhjete*) aksionesh, që perben objektin e kesaj kontrate, është vlerësuar nga palët në vlerën 10,000 euro (*dhjetë mijë euro*), ku vlera per aksion eshte percaktuar të jetë 1,7194 euro/aksiون.

Palet kanë rënë dakord se vlera prej 10,000 euro (*dhjetë mijë euro*) e aksioneve të transferuara nga znj.Jorgjie Balli tek z.Renis Tershana, sipas kesaj kontrate, do të konsiderohet e shlyer per shkak te kompensimit të detyrimeve të ndersjellta midis paleve per të njejten vlere per shkak te marredhenies se detyrimit te huase. Nenshkrimi i kesaj kontrate dhe dakordesia e paleve per kompensimin dhe shuarjen e ndersjellte te detyrimeve kundrejt njeri-tjetrit ne shumen prej 10,000 euro (*dhjetë mijë euro*), passjell dhe shlyerjen e shumes se pageses per transferimin e aksioneve nga Shitesi tek Bleresi.

## MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE

Shitëja është plotësisht dakord dhe transferon ne favor të **Bleresit**, me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë **5,816** (*pese mijë e teteqind e gjashtembedhjete*) **aksiōne** të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A., që zoterohen prej saj ne kapitalin e kesaj shoqerie, kundrejt vleres se çmimit dhe menyres se shlyerjes se ketij çmimi, dakordesuar midis paleve.

Nga ana e tij, **Blerësi**, Z. Renis TËRSHANA, aktualisht zoteron 19,764,009 (*nëntembëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtedhjetë e kater mijë e nëntë*) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A, që përfaqësojnë 23.264 % të kapitalit të kësaj shoqërie dhe është plotësisht dakord të perfitoje 5,816 (*pese mijë e teteqind e gjashtembedhjete*) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A, të zotruara nga shitësja në kapitalin aksionar të Bankës Credins.

Paketa e aksioneve prej 5,816 (*pese mijë e teteqind e gjashtembedhjete*) aksione, që perbejne rrith 0.00720% te total aksioneve, i zbriten perqindjes se aksioneve që zoterohen nga Jorgjie Balli dhe i shtohen perqindjes së zoteruar nga ana e Renis Tershana ne kapitalin e "BANKA CREDINS" sh.a.

Në perfundim të transaksionit palet nenshkruuese të kesaj kontrate do të zoterojne aksionet ne kapitalin e Bankes Credins si vijon:

- 1- Znj.Jorgjie Balli do të zoteroj 428,016 aksione (*katerqind e njezet e tetë mijë e gjashtembedhjete*) që përbëjnë 0.504% te kapitalit;
- 2- Z.Renis Tershana do të zoteroj 19,769,825 aksione (*nentembëdhjetë million e shtatëqind e gjashtedhjetë e nente mijë e teteqind e njezet e pese*) me një pjesemarje 23.270% të kapitalit;

Me nënskrimin e kësaj kontrate transferohet pronësia e aksioneve nga Shitësja tek Blerësi.



## **LIGJI I ZBATUESHEM**

Palët bien dakort që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për cfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi shitjen.

## **KLAUZOLA SHTESË TË KONTRATËS**

Kontrata hartohet në 4 kopje origjinale, duke patur të gjitha vlerë të njëjtë, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e të pavesuar.

**SHITËSI**

Znj. Jorgjia BALLI



**BLERËS**

Znj. Renis TËRSHANA

